

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6708
E shtunë, 17 shtator 2022
çmimi 0.40 €

FSK-së i shtohen edhe 12 kadetë të rinj

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË ME ISH-KRYEMINISTRIN AVDULLAH HOTI | FAQE 4-5


DUHET KOORDINIM I PLOTË PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES FINALE ME SERBINË



Ish-kryeministri dhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, thotë se Evropa duhet të shprehet qartë se synimi i bisedimeve për normalizim me Serbinë është një marrëveshje për njohje reciproke. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Hoti, i cili ndodhet për vizitë në Uashington, ka theksuar se

edhe çështja si ajo për asociacionin duhet të diskutohet pikërisht në kontekstin e kësaj njohjeje. Hoti ka theksuar se në këtë proces duhet koordinim i plotë për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë. Ish-kryeministri ka kritikuar qasjen e qeverisë Kurti për përballjen me problemet e brendshme të vendit

AKTUALE



PUTINI REFUZOI NJË MARRËVESHJE PAQEJE ME KIEVIN REKOMANDUAR NGA NJË NDIHMËS I TIJ F. 2

KURTI STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT TË VJENËS DHE TË VENEDIKUT U FLET PËR TË ARRITURAT E KOSOVËS F. 3

MOZAIKU I ARTISTIT SHQIPTAR PËR ELISABETH II JEHON NË MEDIE NDËRKOMBËTARE F. 6

EKONOMI



"TERMOKOS"-i PRET RAPORTIN E ZRRE-SË PËR TARIFAT E REJA TË NGROHJES F. 8

BANKA BOTËRORE: RRIJJA E NORMAVE TË INTERESIT MUND TË NXISË RECESION NË 2023-n F. 8

SPORT



GIRESSE FTON TRE LOJTARË NGA SUPERLIGA, RIKTHEN PAQARADËN F. 10



GJERMANIA DHE FRANCA, NË NJË DEKLARATË TË PËRBASHKËT, PËRMENDIN HEQJEN E VIZAVE PËR KOSOVËN | FAQE 5



NAGAVCI I PËRGËZON SHKOLLAT DHE MËSIMDHËNËSIT QË KANË FILLUAR MËSIMIN | FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Macedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Putini refuzoi një marrëveshje paqeje me Kievin rekomanduar nga një ndihmës i tij

LONDËR, 16 SHTATOR - Me fillimin e luftës, i dërguari kryesor i Vladimir Putinit për Ukrainën njoftoi udhëheqësin rus se ai kishte arritur një marrëveshje paraprake me Kievin që plotësonte kërkesën e Rusisë, që Ukraina të mos bëjë anëtare e NATO-s. Megjithatë, Putini e refuzoi marrëveshjen dhe vazhdoi me fushatën e tij ushtarake thanë tre persona të afërt me udhëheqjen ruse, të cilët kërkuan të mos identifikohen. Sipas të njëjtave burime, i dërguari me origjinë ukrainase, Dmitry Kozak, i tha Putinit se ai besonte se marrëveshja që kishte arritur, e shmangte nevojën që Rusia të vijonte me një sulm në shkallë të gjerë të Ukrainës. Rekomandimi i Kozakut drejtuar Putinit u njoftua për herë të parë nga agjencia e lajmeve "Reuters", raporton Voa.

Para fillimit të luftës, Putini kishte thënë vazhdimisht se NATO-ja dhe infrastruktura e saj ushtarake po u afroreshin gjithnjë e më shumë kufijve rus, duke pranuar anëtarë të rinj nga Evropa Lindore dhe se, sipas tij, aleanca po përgatitej të sillte në orbitën e saj edhe Ukrainën. Presidenti rus e quajti publikisht këtë një kërcënim për sigurinë e vendit çka, sipas tij, e detyroi të reagoje. Megjithatë i mbështeti fillimisht negociatat, Putini e bëri të qartë kur iu prezantua marrëveshja nga ana e Kozakut, se ajo çka ishte negociuar nga ndihmësi i tij, nuk shkonte aq larg sa duhet dhe se ai i kishte zgjeruar objektivat, duke përfshirë në to edhe aneksimin e një pjese të madhe të territorit ukrainas, thanë të njëjtat burime. Si rezultat marrëveshja u hodh poshtë.


I pyetur në lidhje me gjetjet e agjencisë "Reuters", zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se: "Kjo nuk ka absolutisht asnjë lidhje me realitetin. Nuk ka ndodhur kurrë një gjë e tillë. Është një informacion tërësisht i pasaktë". Kozak nuk iu përgjigj kërkesave për koment të dërguara përmes Kremlinit.

Mykhailo Podolyak, këshilltar i presidentit ukrainas, tha se Rusia i kishte përdorur negociatat si mburojë, për t'u përgatitur për sulmin e saj, por ai nuk iu përgjigj pyetjeve në lidhje me thelbin e bisedimeve dhe as nuk konfirmoi nëse ishte arritur një marrëveshje paraprake. "Sot ne e kuptojmë qartë se pala ruse nuk ka qenë kurrë e interesuar për një zgjidhje paqësore", tha Podolyak.

Dy nga tre burimet thanë se një shtytje për ta finalizuar marrëveshjen ndodhi menjëherë pas sulmit të Rusisë më 24 shkurt. Sipas tyre, brenda disa ditësh Kozak besonte se kishte arritur të binte dakord me Ukrainën për kushtet kryesore të vendosura nga Rusia, ndaj i rekomandoi Putinit nënshkrimin e marrëveshjes. "Pas 24 shkurtit, z. Kozak iu dha drita jeshile dhe ai arriti të siguronte një marrëveshje. Ai e solli atë, por iu tha ta hidhte poshtë. Gjithçka u anulua. Putini, thjesht, e ndryshoi planin, duke bërë përpara me sulmin", tha një nga burimet pranë udhëheqjes ruse.

Burimi i tretë, i cili ishte vënë në dijeni mbi ngjarjet nga persona që ishin informuar mbi diskutimet mes Kozakut dhe Putinit, foli për një tjetër periudhë, se kur i ishte ofruar marrëveshja presidentit Putin. Ai tha se Kozak e kishte njoftuar Putinin mbi marrëveshjen paraprake, pak përpara sulmit. Ofensiva e Moskës në Ukrainë është fushata më e madhe ushtarake në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Ajo ka nxitur sanksione të mëdha ekonomike kundër Rusisë dhe mbështetje ushtarake për Ukrainën nga Uashingtoni dhe aleatët e tij perëndimorë.

Edhe nëse Putini do të ishte pajtuar me planin e Kozakut, nuk është e sigurt nëse kjo gjë do të kishte çuar në përfundimin e luftës. "Reuters" bëri me dije se nuk kishte arritur të verifikonte në mënyrë të pavarur nëse presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskij apo zyrtarë të lartë në qeverinë e tij kishin rënë dakord



me kushtet e marrëveshjes paraprake.

Gjashtëdhjetetrevjeçari Kozak ka qenë një prej njerëzve besnikë të Putinit që prej viteve 1990.

Pozitat e tij ishin të forta në raport me negociimin e një marrëveshjeje paqeje, sepse që nga viti 2020 presidenti rus e kishte ngarkuar atë të zhvillonte bisedime me homologët ukrainas për rajonin e Donbasit, në Ukrainën lindore. Prej vitit 2014 ky rajon kontrollohet nga separatistët e mbështetur nga Rusia.

Në krye të delegacionit rus, në bisedimet me zyrtarë ukrainas në Berlin, më 10 shkurt, të ndërmjetësuar këto nga Franca dhe Gjermania, Kozak tha në një konferencë shtypi në mbrëmje,

se raundi i fundit i negociatave kishte përfunduar pa ndonjë përparim.

Kozak ishte, gjithashtu, një nga zyrtarët e pranishëm në një takim të Këshillit të Sigurisë, të thirrur nga Putini tri ditë para sulmit në Ukrainë, ku morën pjesë krerët ushtarakë, ata të sigurisë, si dhe ndihmësit kryesorë të Kremlit.

Kamerat e televizionit shtetëror regjistruan një pjesë të takimit, ku Putini paraqiti planet për t'i njohur zyrtarisht entitetet separatiste në Ukrainën lindore. Pasi kamerat u nxorën jashtë, Kozaku foli kundër planeve që Rusia t'i përshkallëzonte tensionet me Ukrainën, thanë dy nga tre personat e afërt me udhëheqjen ruse, si dhe një person i tretë që mësoi rreth

këtyre zhvillimeve nga njerëz të pranishëm në takim.

Një tjetër person, i intervistuar nga "Reuters", i cili ndihmoi në bisedime pas sulmit në Ukrainë, tha se negociatat u prishën në fillim të muajit mars, kur zyrtarët ukrainas e kuptuan se Putini ishte i bindur për të ecur përpara me sulmin në shkallë të gjerë.

Rreth shtatë muaj nga fillimi i luftës, Kozak vazhdon ta mbajë postin e zëvendëssefit të kabinetit në Kremlin, por ai nuk po merret më me çështjen e Ukrainës, sipas gjashtë prej burimeve që folën për agjencinë "Reuters". "Nga ajo që unë kam vënë re, Kozak është zhdukur fare", tha një nga gjashtë burimet, një person i afërt me udhëheqjen separatiste në Ukrainën lindore.

Scholz: Ushtria e Gjermanisë duhet të jetë më e pajisura në Evropë



BERLIN, 16 SHTATOR - Gjermania është e gatshme të marrë rol udhëheqës në garantimin e sigurisë së Evropës, ka thënë kancelari gjerman Olaf Scholz. Ai është zotuar për ta bërë ushtrinë e shtetit "më të pajisurën" në kontinent.

Duke e konsideruar Rusinë si "kërcënimin më të madh" të NATO-s, Scholz ka thënë se Evropa duhet të jetë e përgatitur për përballje. "Ne

po e bëjmë shumë të qartë: Gjermania është e gatshme të marrë përgjegjësi për sigurinë e kontinentit tonë", ka thënë ai në një kongres për armët. "Si shteti më i populluar, me ekonominë më të madhe, dhe si shtet që gjendet në mes të kontinentit, ushtria jonë duhet të jetë gurthemel i mbrojtjes sonë konvencionale në Evropë, duhet të jetë forca më e pajisur në Evropë", ka thënë

Scholz.

Scholz ka thënë se ushtria gjermane për shumë kohë është angazhuar për "sigurim të ndihmës humanitare, për ofrim të ndihmës pas vërshimeve dhe në përpjekjet për vaksinim kundër pandemisë". "Mirëpo ai nuk është misioni kryesor. Qëllimi kryesor është mbrojtja e lirisë në Evropë", ka thënë kancelari gjerman Olaf Scholz.

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Gjermania dhe Franca, në një deklaratë të përbashkët, përmendin heqjen e vizave për Kosovën

PRISHTINË, 16 SHTATOR - I ashtuquajtur "Trekëndësh i Weimarit", i cili përfshin një format të tri shteteve, Gjermanisë, Francës dhe Polonisë, kanë lëshuar të premtën një deklaratë të përbashkët rreth zhvillimeve të fundit gjeopolitike, përfshirë edhe ngjarjet në Ballkan.

Në një deklaratë të përbashkët të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, të Francës dhe të Polonisë, thuhet se tri shtetet bëjnë thirrje për përparim në çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. "Trekëndëshi i Weimarit" thotë se e mbështet plotësisht dialogun ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë dhe thekson "nevojën për një marrëveshje gjithëpërfshirëse që i mundëson Kosovës dhe Serbisë të avancojnë në rrugëtimin e tyre evropian". "Ne e mbështesim plotësisht dialogun Kosovë - Serbi të udhëhequr nga BE-ja dhe theksojmë nevojën për një marrëveshje gjithëpërfshirëse

që i mundëson Kosovës dhe Serbisë të avancojnë në rrugëtimin e tyre evropian dhe të kontribuojnë në stabilitetin në rajon", thuhet në njoftim. "Ne bëjmë thirrje për progres në lidhje me liberalizimin e vizave për Kosovën", thuhet në komunikatë. Po në komunikatë bëhet me dije se

vendet tona janë të përkushtuara fuqishëm ndaj Procesit të Berlinit. "Ne theksojmë rëndësinë e zbatimit të vendimit historik nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor për të krijuar një treg të përbashkët rajonal", thuhet në komunikatën e përbashkët të tri ministrive të jashtme.



Kurti studentëve të Universitetit të Vjenës dhe të Venedikut u flet për të arriturat e Kosovës



PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bashkëbiseduar të premtën me studentët nga Universiteti i Vjenës dhe ai i Venedikut.

Kurti ua ka paraqitur të arriturat e gjithëmbarshme të Kosovës, sidomos përparimin ekonomik dhe demokratik në vitin e fundit. "Para rreth 90 studentëve ndërkombëtarë që vijojnë studimet master për të

drejtat e njeriut dhe demokratizim, ai foli për arritjet e qeverisë dhe për reformat e filluara, veçanërisht në sistemin e drejtësisë, luftën kundër krimit dhe korrupsionit, si dhe për politikën e jashtme dhe synimet e Republikës së Kosovës për integrim në organizatat ndërkombëtare", ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Pas prezantimit të shkurtër, kryeministri ka bashkëbiseduar

me studentët dhe profesorët e pranishëm të cilët kanë bërë pyetje dhe zgjeruar diskutimin mbi pikat e programit të qeverisë, që lidhen me ekonominë dhe investimet, drejtësinë dhe procesin e vetingut, si dhe edukimin dhe sistemin dual të arsimit. Studentët dhe profesorët e pranishëm e kanë falënderuar kryeministrin Kurti për këtë diskutim.

Vazhdon bashkëpunimi në mes të FSK-së dhe KFOR-it

Prishtinë, 16 shtator - Komandanti i FSK-së, gjeneralletjtenant Bashkim Jashari, ka pritur të premtën në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor

Ferenc Kajari. Të dy gjeneralët diskutuan për bashkëpunimin në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe misionit të KFOR-it në Kosovë, gjithashtu edhe për

situatën e sigurisë në Kosovë dhe rajon. "Të dy gjeneralët u pajtuan për vazhdim të bashkëpunimit të aktivitetëve si dy institucione kyçe të sigurisë në vendin

tonë. Në fund, gjeneral Jashari falënderoi gjeneralin Kajari për shërbimin e ushtarakëve të saj në misionin e KFOR-it", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.





INTERVISTË ME ISH-KRYEMINISTRIN AVDULLAH HOTI

Duhet koordinim i plotë për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë

Ish-kryeministri dhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, thotë se Evropa duhet të shprehet qartë se synimi i bisedimeve për normalizim me Serbinë është një marrëveshje për njohje reciproke. Në një intervistë për “Zërin e Amerikës”, Hoti, i cili ndodhet për vizitë në Uashington, ka theksuar se çështja si ajo për asociacionin duhet të diskutohet pikërisht në kontekstin e kësaj njohjeje. Hoti ka theksuar se në këtë proces duhet koordinim i plotë për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë. Ish-kryeministri e ka kritikuar qasjen e qeverisë Kurti për përballjen me problemet e brendshme të vendit

PRISHTINË, 16 SHTATOR- *Flasim fillimisht për dialogun. Siç e pamë, Lajçaku ishte të enjten në Prishtinë për një vizitë të paparalajmëruar dhe Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian po shpresojnë për nxitjen e këtij dialogu. Si e shihni ju procesin dhe çfarë parashikoni këtë e tutje?*

Hoti: Besoj se është një moment i mirë duke parë interesimin e shtuar të partnerëve tanë ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara në veçanti dhe përfaqësuesit që ata e kanë caktuar, emisarin special për Ballkanin Perëndimor që e mbulon edhe çështjen e dialogut, z. Escobar. Më pas e kemi përfaqësuesin e qeverisë

gjermane dhe këshilltarin e lartë të presidentit Macron dhe përfaqësuesin special për Ballkanin Perëndimor nga Britania dhe z. Lajçak, pra ka një koordinim më të mirë sesa që ka pasur në të kaluarën. Ajo që po mungon është qartësia në gjithë këta partnerë në qëllimin final të dialogut që është arritja e marrëveshjes përfundimtare për njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve. Shtetet e Bashkuara gjithmonë kanë qenë shumë të qarta edhe me letrat e fundit që kemi parë nga presidenti Biden dhe sekretari Blinken. Por e njëjta gjë kërkohet edhe nga partnerët evropianë për ta bërë presionin e nevojshëm ndaj Serbisë për të

ardhur te marrëveshja përfundimtare dhe nevojat që kemi në brenda Kosovës për koordinim më të mirë dhe transparencë të plotë për këtë proces të dialogut dhe që është duke munguar.

Pra, ju thoni që kjo lloj paqartësie dhe, si duket, një ndryshim mes qëndrimit të ShBA-së dhe BE-së, gjithashtu krijon pengesa edhe për procesin e mëtejshëm?

Hoti: Unë nuk besoj që ka qëndrime të ndryshme, por është më shumë qartësia pse po hyjmë tani në fazën finale të dialogut. Unë e kam parasysh që brenda BE-së ka ende vende që nuk e njohin Kosovën, por gjërat duhet thënë qartë që ky

është proces për marrëveshje për njohje reciproke dhe normalizim marrëdhëniesh. Nuk është proces teknik për të arritur marrëveshje të caktuara teknike në terren pavarësisht sa të rëndësishme ato marrëveshje janë, por është një proces që duhet ta përmbyllë njëherë e përgjithmonë çështjen mes të dy vendeve në rajon.

Një nga pikat që kanë ngritur diplomatët perëndimorë është ajo për të siguruar mbrojtje për pakicën serbe. Sipas disa vëzhguesve, kjo nënkupton një Asociacion të Komunave me Shumicë Serbe me më shumë fuqi sesa kërkon Prishtina zyrtare dhe me më pak sesa kërkon Beogradi. Sipas jush, si mund të duket ky lloj Asociacioni?

Hoti: Për të qenë i qartë, besoj se të gjithë e pranojnë që pakica serbe, komuniteti serb në Kosovë, është shumë i mbrojtur. Standardet që ne i zbatojmë ndaj pakicave janë ndoshta më të lartat në Evropë.

Problemi është ndikimi i Serbisë te komuniteti serb në Kosovë. Janë bërë përpjekje në të kaluarën për ta integruar komunitetin serb brenda institucioneve me anën e marrëveshjeve të arritura në qeveritë paraprake disa prej të cilave marrëveshje edhe qeveria tani është duke i zbatuar. Problemi mbetet që Serbia vazhdon të ketë ndikim te komuniteti serb në Kosovë duke e penguar integrimin e tyre të plotë në jetën ekonomike dhe shoqërore në Kosovë.

Escobari ka thënë që nëse Prishtinës nuk i pëlqen ajo marrëveshje që është bërë për Asociacionin, atëherë le të vijë me propozim të vetin. Cili është mendimi juaj?

Hoti: Marrëveshja për Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është arritur në Bruksel dhe është shumë e qartë që kjo Bashkësi e Komunave nuk ka kompetenca ekzekutive dhe ajo që është shumë e rëndësishme atëherë me qeverinë (e udhëhequr nga

Nagavci përgëzon shkollat dhe mësime të reja që kanë filluar mësimin

“Epoka e re”

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHIT), Arbërie Nagavci, ka thënë sot se janë të përkushtuar që ta adresojnë secilën vështirësi me të cilën ballafaqohen mësime të reja në Kosovë krahas punës që po bëjnë për përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e politikave arsimore. “Këtë po e theksojmë vazhdimisht gjatë vizitave të përditshme në shkolla, ku bashkë me zëvendësministrat e Arsimit dhe zyrtarët e tjerë të ministrisë po bashkëbisedojmë me mësime të reja, edhe me prindërit, për shqetësimet e tyre. E kemi fokusuar bashkëbisedimin me mësime të reja të politikave dhe reja në mbështetje të tyre, në mënyrë që ta tejkalojmë secilën vështirësi së bashku, sikur që është tejkalluar ajo e

mësime të reja me probleme serioze shëndetësore dhe nuk ka më asnjë mësime të reja që i duhet të dalë në punë sepse i nevojitet paga për të blerë ilaçe”, ka shkruar Nagavci në “Facebook”.

Ajo i ka përgëzuar shkollat dhe mësime të reja që kanë filluar mësimin dhe ka kërkuar nga të gjithë mësime të reja e Kosovës që ta mirëkuptojnë situatën, tashmë kur ata dhe familjet e tyre do të përfitojnë nga pakjoja e ndihmave financiare. “Theksoj se në Projektligjin për Paga, i cili ka dalë në debat publik, janë marrë për bazë të gjitha kërkesat, duke u trajtuar me kujdes të veçantë të gjitha kategoritë e punëtorëve të arsimit. I siguroj mësime të reja se do të adresohet vazhdueshëm çdo shqetësim i tyre dhe bashkërisht t’i evitojmë të gjitha vështirësitë për të arritur kështu që të kemi mirëqenie të mësime të reja dhe ngritje të cilësisë në arsim”, ka shkruar Nagavci.

Jasharaj: Secili mësime të reja që mendon se mësime duhet të fillojë është i lirë ta bëjë

Edhe pse është dita e 24 e grevës së Sindikatës së Bashkuar të Arsimit (SBASHK), disa shkolla në qytete të ndryshme të vendit e kanë filluar vitin e ri shkollor. Në komunën e Podujevës të gjitha shkollat fillore e kanë nisur pjesërisht mësimin, ndërsa edhe në komunën e Gjakovës tashmë pesë shkolla e kanë nisur procesin mësime. Në lidhje me këtë, Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut, në një prononcim për “Telegrafin”, ka thënë se secili mësime të reja që mendon se duhet të fillojë mësime, është i lirë ta bëjë. Sipas tij, nëse ekziston që ndonjë shkollë e ka filluar procesin

mësime, SBASHK-u do ta bëjë publike këtë gjë. “Unë po pres që ta vizitoj edhe Këshillin Grevist e do të marrë informacione të sakta, pasi mund të ketë tendenca të DKA-së. Ne nuk do ta fshehim. Këshilli Grevist do ta japë raportin final. Në SBASHK ka demokraci dhe punëtorët e kanë kërkuar grevën. Vetëm ata do të vendosin se çfarë do të bëhet tutje dhe cilido individ që mendon se duhet t’i kthehet mësimit ne nuk kemi asgjë kundër. Ata vendosin, pasi ne e kemi shpallur grevën, duke u bazuar në kërkesën e tyre”, ka thënë ai.

Jasharaj, po ashtu, tha se

SBASHK-u është në komunikim të përditshëm me kryetarët e nivelit komunal dhe të universiteteve për të marrë raporte të hollësishme për situatën që e kanë në secilën komunë dhe universitet. “SBASHK-u është në komunikim të përditshëm me kryetarët e nivelit komunal dhe të universiteteve, merr raporte të detajuara nga situata në secilën komunë dhe universitet. Ata i sjellin informacionet që i marrin nga kryetarët e shoqatave sindikale. Këto takime të përditshme po i mbajmë online”, ka thënë Jasharaj.



ish-kreu i LDK-së, Isa) Mustafa është insistuar dhe është bërë pjesë e marrëveshjes një pikë e cila thotë që statuti i Bashkësisë përpara se të miratohet nga qeveria e merr miratimin ose opinionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe këtë fakt e ka pranuar edhe Serbia. Kështu që besoj se gjërat janë të qarta. Krejt këto çështje duhet të diskutohen në kontekst të marrëveshjes përfundimtare për njohjen reciproke. Nuk guxohet dhe unë këtu besoj se Qeveria e Kosovës po bën gabim. Nuk guxojmë të lëshohemi në çështje të caktuara, nuk po them teknike, se të gjitha janë politike, por në

çështje të caktuara që nuk janë pjesë e marrëveshjes finale. Ne tash duhet të kërkojmë koordinim të plotë për arritje të marrëveshjes finale në mes të dy vendeve.

Por ju keni qenë në një pozicion të tillë si kryeministër. Po të ishit ju në pushtet, ose kur ishit në pushtet, a nuk i pranoni këto lloj marrëveshjes?

Hoti: Kur kam qenë unë kryeministër e kemi kornizuar procesin e dialogut dhe e kemi filluar procesin e dialogut për marrëveshje përfundimtare për njohje reciproke nën parimet kryesore që nuk diskutohen integriteti territorial i vendit, nuk diskutohet karakteri unitar

i shtetit të Kosovës që e përjashton Asociacionin me kompetenca ekzekutive dhe çdo gjë që bisedohet, bisedohet në kontekst të marrëveshjes përfundimtare. Nuk pajtohem për asgjë derisa nuk pajtohem për marrëveshjen për njohje reciproke. Braktisja e kësaj kornize të dialogut nga qeveria ekzistuese besoj që e ka futur në telashe, në rrugë pa krye qeverinë.

Të flasim pak për marrëdhëniet në mes të shumicës dhe opozitës. Debatimi që i ashpër sot në Kuvend. Si e shikoni ardhmërinë e këtyre marrëdhënieve dhe si e shikoni zgjidhjen e këtyre problemeve të politikës së

brendshme?

Hoti: Unë besoj se ballafaqimet pozitive-opozitive duhet t’i shohim në kontekst të demokracisë së brendshme që duhet të ketë secili vend. Por, në rastin tonë, unë besoj se qeveria ka shkuar bukur larg në konfrontim, jo vetëm me opozitën, sepse për nga natyra ne presim që të kemi ballafaqim për jetë më të mirë të qytetarëve mes pushtetit dhe opozitës, por ka hapur front me të gjitha grupet e shoqërisë: me sindikatat, me komunitetin e bizneseve, me mediet dhe me grupet e tjera. Unë besoj se kjo është totalisht e papërgjegjshme. Ne jemi duke e kryer punën tonë si opozitë në Kuvend edhe jashtë Kuvendit

duke u ofruar zgjidhje, por qasja e qeverisë në përballje me këto probleme me të cilat po kalojmë nuk është adekuate dhe besoj se mund të presim përkeqësim të situatës në terren, në fushën ekonomike, në fushën sociale e fillim të krizës ekonomike, me inflacion, me krizën energjetike dhe tash ballafaqimi krejt i panevojshëm me sindikatat. Kërkesat e sindikatave janë plotësisht të arsyeshme. Pozita fiskale dhe financiare e qeverisë është shumë e mirë për shkak të të hyrave që ka pasur nga rritja e çmimeve dhe nuk ka asnjë arsye pse të mos plotësohen këto kërkesa të sindikatave deri në miratimin e Ligjit të Pagave.

Mozaiku i artistit shqiptar për Elisabeth II jehon në medie ndërkombëtare

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Artisti shqiptar Alkent Pozhegu ka mahnitur me mozaikun e tij kushtuar Mbretëreshës Elizabeth II e cila ka ndërruar

jetë rreth një javë më parë. Mozaiku është bërë me fasule, grurë, fara luledielli, oriz, misër e drithëra të tjera me ngjyra.

Artisti shqiptar nga Kosova ka treguar se për veprën muzeale iu deshën 100-120 kilogramë drithë, ndërsa punoi rreth gjashtë orë. “Kam

përdorur fasule, grurë, fara luledielli, oriz e drithëra me ngjyra. Më janë dashur rreth 100-120 kg drithë”, ka treguar ai.



Kryetari i Gjilanit del në terren, inspekton asfaltimin e rrugëve



GJILAN, 16 SHTATOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, me bashkëpunëtorë, ka vizituar punimet e asfaltimit të rrugëve në fshatin Nasalë dhe të segmentit të rrugës “15 Qershori” në lagjen Dardania. Gjatë vizitës së punimeve në Nasalë, ai ka thënë se me asfaltimin e këtyre rrugëve atje po e përmbyllin pjesën e projektimit dhe të asfaltimit të rrugëve të shtëpive dhe lagjeve të fshatit. “Është

projekt i cili është pritur gjatë, ndoshta më shumë se 20 vjet. Sot është bërë asfaltimi i njëres prej tri pjesëve kryesore të rrugëve, ndërkohë që janë asfaltuar edhe rrugicat. Janë diku 100 metra gjatësi të asfaltit me gjerësi prej katër metrash dhe në këtë formë fshatin Nasalë po e përmbyllim me pjesën e projektimit dhe të asfaltimit të rrugëve përbrenda shtëpive dhe lagjeve të fshatit. Është një praktikë dhe një qasje e re.

Nuk premtojmë, por vetëm punojmë dhe angazhohemi maksimalisht. I falënderoj banorët për pritjen dhe për durimin që e kanë pasur deri tash”, ka thënë Hyseni. Drejtori i Shërbimeve Publike, Mentor Mihovci, ka thënë se pas përfundimit të asfaltimit të segmentit të rrugës nga furra “Aroma” deri te shkolla “Selami Hallaqi” do të bëhet shenjzimi horizontal dhe vertikal, ndërkaq parkingjet do të kthehen në formë të drejtë.

Në fshatin Vajnik nis ndërtimi i poligonit sportiv

SKENDERAJ, 16 SHTATOR - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se në vazhden e realizimit të projekteve të reja kapitale, në fshatin Vajnik ka nisur ndërtimi i poligonit sportiv për shkollën e fshatit, ku nxënësit e saj dhe të rinjtë e tjerë të kësaj ane do të mund të zhvillojnë aktivitete sportive në kushte më të mira.

Për ta parë ecurinë e punimeve, kanë dalë për vizitë kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, nënkryetari Sami Lushtaku, drejtori për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Driton

Mulaj. E pranishme ishte edhe anëtarja e Kuvendit Komunal, Besjana Thaçi. Gjatë vizitës udhëheqësit e komunës kanë diskutuar me përfaqësuesit e kompanisë e cila po zhvillon punimet, duke kërkuar realizim dhe përfundim të projektit sipas kushteve dhe standardeve. Ndërtimi i poligonit sportiv në Vajnik pason atë të Lubovecit, ku dy këto projekte financohen nga buxheti i komunës së Skenderajt dhe janë pjesë e programit qeverisës të kryetarit Nura për sportin dhe rininë.



Siguria në komunën e Malishevës, e lartë



Malishevë, 16 shtator - Situata e sigurisë së përgjithshme në komunën e Malishevës është e lartë dhe pa tendencë të destabilizimit. Kështu kanë thënë organet përgjegjëse për siguri, në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i cili drejtohet nga kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati. “Bazuar në të dhënat e raportuara nga ana e organeve përgjegjëse për siguri, duke filluar nga Stacioni Policor në Malishevë dhe organet e tjera, situata e sigurisë së përgjithshme

konsiderohet e qetë dhe pa tendencë të prishjes. Po ashtu, bazuar në të dhënat e shtabeve emergjente komunale, edhe situata me pandeminë Covid-19 dhe me EHKK është stabile dhe nën kontroll. Aktualisht kemi vetëm një rast aktiv me Covid, ndërsa me EHKK nuk kemi pasur asnjë rast të infektuar”, ka thënë kryetari Kastrati në takimin e rregullt të KKSB.

Togeri policor Zenel Halitaj, nga Stacioni i Policisë në Malishevë, e ka vlerësuar të qetë situatën e sigurisë së përgjithshme dhe ka bërë me

dije se, krahasuar me vitet e tjera, ka rënie të rasteve të veprave penale. Sipas tij, siguria në trafik është shumë e lartë si dhe ka rritje të zbulimit të veprave penale falë bashkëpunimit të mirë me qytetarët.

Ndërkaq drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Shqipron Shala, në raportimin e tij, ka njoftuar se deri në këtë periudhë kohore nuk ka situata emergjente në fushën e zjarreve, përmblytjeve apo të natyrave të tjera në të cilat nevojitet ndërhyrja e njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimin.

Kryetari i Rahovecit dhe ai i Mamushës thellojnë bashkëpunimin

Rahovec, 16 shtator - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtorin e BPZHR-së në Rahovec, Berat Duraku, kanë pritur në takim kryetarin e

Mamushës, Abdylhadi Krasniqi dhe drejtorin e bujqësisë të kësaj komune, Ruzhdi Mazreku. Latifi ka treguar se në këtë takim është biseduar për

gjendjen aktuale, ecurinë e punëve dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen si komuna, si dhe për arritjet që kanë para vetes në projekte të ndryshme. “Bashkërisht u

pajtuam ta thellojmë bashkëpunimin për projekte me interes për të dy komunat dhe për çështje të tjera të interesit të përbashkët”, ka thënë Latifi.



Rama dhe Nagavci diskutojnë për ndërtimin e disa shkollave dhe çerdheve të reja

Prishtinë, 16 shtator - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur të premtën në takim ministren e Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe të Inovacionit, Arbërie Nagavci, me të cilën ka diskutuar për gjendjen e arsimit në kryeqytet. Rama ka bërë me dije se janë në proces të ndarjes së

lokacioneve për ndërtimin e disa shkollave dhe çerdheve të reja, për ndërtimin e të cilave Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit ka shprehur gatishmërinë për të bashkinvestuar. "Unë besoj fuqishëm se arsimit cilësor dhe ofrimi i infrastrukturës për shfrytëzimin maksimal të

potencialeve të të rinjve tanë ka ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e Prishtinës në përgjithësi, andaj jemi të gatshëm për çdo lloj forme bashkëpunimi në këtë drejtim. Falënderoj ministren Arbërie Nagavci për gatishmërinë dhe frymën bashkëpunuese", ka thënë kryetari Rama pas takimit.



FSK-së i shtohen edhe 12 kadetë të rinj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Në kazermën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) "Adem Jashari" në Prishtinë është mbajtur të premtën ceremonia e betimit të dymbëdhjetë kadetëve të rinj të Akademisë së Mbrojtjes së FSK-së,

gjenerata 2026.

Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, zyrtarë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, si dhe zyrtarë dhe ushtarakë ndërkombëtarë. Duke i uruar kadetët për këtë ditë të

veçantë në jetën e tyre, ministri Mehaj ka theksuar se në katër vitet e ardhshme ata do të përgatiten për karrierë të përsosmërisë profesionale në shërbim të atdheut, si oficerë në Ushtrinë e Republikës së Kosovës. "Nga ju kërkoj që për katër vitet e ardhshme ta arrini zhvillimin e duhur ushtarak, fizik dhe moral dhe të formësoheni në

udhëheqës me karakter. Kjo do të na bëjë të gjithëve shumë të lumtur dhe krenarë", ka thënë Mehaj, duke shtuar se pas katër vjetëve këta kadetë do të jenë të gatshëm të bashkohen në stërvitje dhe operacione ndërkombëtare në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. "Do të jeni krah për krah me kolegët tuaj

nga forcat partnere", ka thënë Mehaj.

Ndërsa zëvendëskomandanti i QSU-së, kapiten Alban Ajvazi, ka folur për historikun dhe të arriturat e QSU-së dhe synimet për të ardhmen për edukimin e kadetëve të kësaj gjenerate dhe gjeneratave që janë duke ndjekur aktualisht studimet në këtë qendër.



Profesori nga Australia, Pedy Dewan, operon 13 fëmijë me probleme të lindura kongjenitale

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Në misionin e tij të katërbëdhjetë në Kosovë, profesori i njohur nga Australia, Pedy Dewan, bashkë me ekipin vendas të Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës po operojnë fëmijë me probleme të lindura kongjenitale. Deri më tani janë kryer 13

operacione të komplikuar, kurse parashihet që gjatë këtij misioni të kryhen gjithsej 17 operacione.

Ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi, ka takuar profesorin nga Australia dhe e ka falënderuar për bashkëpunimin dhe kontributin e vazhdueshëm për fëmijët e Kosovës.

Ajo u shpreh e gatshme për zgjerim të bashkëpunimit të

mëtejshëm, duke ofruar gjithë përkrahjen e nevojshme institucionale me qëllim që rastet e fëmijëve që kanë komplikime kongjenitale të operohen në Kosovë dhe mos të kenë nevojë të dalin jashtë vendit.

Drejtoresha bashkë me profesor Dewan dhe drejtorin e Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve, Ardian Shefkiu, kanë vizituar disa nga fëmijët që me sukses të plotë janë operuar.

Në zonën e Dragashit vazhdojnë kërkimet për 26-vjeçarin e zhdukur para dy javësh

Prishtinë, 16 shtator - Policia e Kosovës me zyrtarët e saj të rendit dhe të Policisë Kufitare, Policia e Shqipërisë, Forca e Sigurisë së Kosovës, OJQ-ja e Kosovës për Kërkim Shpëtim,

Policia e Maqedonisë në pjesën e saj dhe qytetarë nga Kosova dhe Shqipëria kanë vazhduar kërkimin e personit të zhdukur ditë më parë. Gjatë kërkim-shpëtimit janë

përdorur qentë e kërkimit, pajisje si motorë terreni, dronë dhe paragllajd me motor. Kërkimi i personit do të vazhdojë, andaj policia i falënderon të gjithë për

bashkëpunimin dhe angazhimin e deritanishëm, njëkohësisht i fton qytetarët nëse kanë ndonjë informacion ta njoftojnë policinë.



“Termokos”-i pret raportin e ZRrE-së për tarifatat e reja të ngrohjes

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Zëdhënësja e ngrohjes së qytetit, Afërdita Uka, thotë se po presin raportin e ZRrE-së për caktimin e tarifave të ngrohjes. Megjithatë, ajo shpreh optimizim se nuk do të ketë shtrenjtim të tarifave edhe këtë dimër, ku konsumatorët do të ngrohen me të njëjtat çmime. Ajo shton se pjesa më e madhe e përgatitjeve ka përfunduar dhe presin furnizim të mjaftueshëm dhe cilësor. Në një deklaratë për “Kosovapress”, zëdhënësja e “Termokos”-it tregon se ekipet në terren po punojnë intensivisht para nisjes së sezonit të ngrohjes. “Pjesa më

e madhe përgatitjeve tanimë kanë përfunduar, kanë mbetur edhe disa punë teknike të kryhen, për të cilat janë duke punuar intensivisht të gjitha ekipet tonë në terren dhe Departamenti i Prodhimit këtu në objektin e ‘Termokos’-it. Ne presim një sezon të mbarë ngrohës në bashkëpunim të ngushtë sikur deri më tani që nga viti 2014, kur është realizuar projekti i koogjenerimit. Ashtu siç kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyer me termocentralin Kosova B, presim që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe ne do të jemi në gjendje të furnizojmë me ngrohje të mjaftueshme dhe

cilësore rreth 16 mijë konsumatorë”, ka deklaruar ajo.

E pyetur për shtrenjtimin e çmimeve të ngrohjes, Uka thotë se po presin raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për tarifatat e sezonit të ri ngrohës. “Kemi aplikuar në Zyrën e Rregullatorit për Energjinë për tarifatat e reja. ZRrE-ja është autoriteti i vetëm që përcakton tarifatat e ngrohjes. Shumë shpejt pritet ta kemi raportin e ZRrE-së për tarifatat e sezonit të ri ngrohës 2022-2023. Sipas të gjitha indikacioneve, nuk pritet se do të ketë shtrenjtim të këtyre tarifave. Besojmë se do ta vazhdojmë furnizimin me

ngrohje me tarifatat që kanë qenë në fuqi deri më tani”, thekson ajo.

Ajo ka folur edhe për zgjerimin e rrjetit të ngrohjes edhe në lagje të tjera të Prishtinës. Uka deklaroi se janë mbi 140 objekte banesore që do të kyçen në ngrohoren e qytetit. “Deri më tani është shtrirë rrjeti i ngrohjes për lagjen Mati 1, përkatësisht rrugën ‘Muharrem Fejza’ dhe rrugicat përreth saj janë 141 objekte banesore të reja të cilat do të kyçen për herë të parë në rrjetin e ngrohjes... Fillimi i furnizimit me ngrohje do të bëhet gradualisht... Një pjesë e tyre

do të fillojë të furnizohet me ngrohje që nga 15 tetori kur pritet zyrtarisht fillimi i sezonit ngrohës, pjesa tjetër gradualisht do të kyçet në rrjetin e ngrohjes pasi që është në proces instalimi i stacioneve të ngrohjes. I kemi edhe 76 objekte të vjetra banesore në qytetin Prishtinës të cilat janë të shpërndara në të gjitha lagjet e qytetit ku ne operojmë me ngrohje”, ka thënë ajo.

Ngrohitorja e qytetit “Termokos” do ta nisë sezonin e ngrohjes më 15 tetor.

Para disa ditësh Fisnik Osmani është zgjedhur kryeshef ekzekutiv i “Termokos”-it.




Banka Botërore: Rritja e normave të interesit mund ta nxisë recesion në 2023-n

WASHINGTON, 16 SHTATOR - Rritja e normave të interesit nga bankat qendrore në botë mund të nxisë recesion global në vitin 2023, ka njoftuar Banka Botërore.

Bankat qendrore kanë rritur normat e interesit “duke vepruar sipas një sinkroni që nuk është parë në pesë dekadat e fundit”, për ta luftuar rritjen e çmimeve, ka thënë ky institucion.

Recesioni përshkruhet si tkurrje e ciklit të bizneseve dhe, për pasojë, ka rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik. Rritja e normave të interesit e bën huamarrjen më të shtrenjtë dhe kështu tentohet të luftohet rritja e çmimeve. Megjithatë, një vendim i tillë i bën edhe kreditë më të kushtueshme, diçka që



mund ta ngadalësojë rritjen ekonomike.

Ky njoftim i Bankës Botërore

vjen pas takimit të zyrtarëve të Bankës amerikane të Rezervave, dhe Bankës së

Anglisë, të cilat pritet t'i rrisin sërish normat e interesit javën e ardhshme.

Të enjten Banka Botërore ka njoftuar se ekonomia globale është duke ecur me ritmin më të ngadalshëm prej vitit 1970. “Në situata të tilla, edhe një goditje jo shumë e madhe në ekonominë globale, mund të nxisë recesion vitin e ardhshëm”, ka njoftuar Banka Botërore.

Ajo u ka bërë thirrje bankave qendrore që t'i koordinojnë veprimet dhe të “bisedojnë qartë për vendimet e tyre” për t'i shmangur vështirësitë më të mëdha.

Në Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëri të Bashkuar është regjistruar së fundi niveli më i lartë i inflacionit në 40 vjetët e

fundit.

Kjo situatë është rezultat i rritjes së kërkesës pas heqjes së kufizimeve për luftim të pandemisë së koronavirusit dhe pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, e cila ka ndikuar në rritje të çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimeve.

Presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Ai e quan luftën si “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

12 oligarkët dhe menaxherët rusë që kanë vdekur në rrethana misterioze që nga fillimi i luftës në Ukrainë

Nga Maurizio STEFANINI

Vladimir Putin mund Agata Kristin? "Dhjetë indianët e vegjël" është libri i shkrimtares angleze, që shiti mbi 110 milionë kopje, duke thyer të gjitha rekordet. Ai rrëfen historinë e 10 të ftuarve në një vilë në një ishullin Devon, të cilët vdesin një e nga një në kohë të caktuara dhe përmes mënyrave të tmerrshme.

Ndërkohë në Rusi numërohen tashmë 12 oligarkë dhe menaxherë rusë, që kanë vdekur në një mënyrë misterioze që nga fillimi i këtij viti. Por nëse lëmë mënjanë numrin, ekzistojnë të paktën 4 dallime të rëndësishme. Së pari, skena e ngjarjeve nuk është një ishull pa asnjë mjet komunikimi me botën, por e gjithë Evropa dhe madje edhe SHBA-ja. Së dyti, ritmi që shoqëron këto vdekje nuk është një këngë, por lajmet e luftës në Ukrainë.

Së treti ndërsa në librin e Kristit, autori mbetet i pa dyshuar deri në fund, në rastin konkret kushdo që e njuh sadopak Rusinë, sugjeron se pas këtyre vdekjen qëndron Putin. Dhe e katërta, historia e Agata Kristit është e trilluar, ndërsa vdekja e 12 rusëve është një fakt ivërtetë.

I fundit që vdiq është Ravil Maganov. Nëndrejtor i kompanisë "Lukoil" dhe kryetar i Bordit të Drejtorëve. Zyrtarisht u raportua se humbi jetën pasi u "rrezua" nga dritarja e katit të gjashtë të Spitali Klinik Qendror në Moskë, ku sapo kishte vdekur Gorbaçovi, dhe që konsiderohet si spitali më i mirë në Rusi.

Ai ishte 67 vjeç, dhe në një deklaratë të saj kompania "Lukoil" shprehet: "Me hidhërim të madh ju njoftojmë se Ravil Maganov, kryetar i Bordit të Drejtorëve, ka vdekur pas një sëmundjeje të rëndë. Ravil Ulfatoviç dha një kontribut të paçmuar jo vetëm në zhvillimin e kompanisë, por të gjithë industrinë ruse të naftës dhe gazit".

Asnjë përmendje të rrethanave të vdekjes së tij. Disa zëra folën për edhe për problemet e zemrës dhe zhytjes në një depresion të thellë. Agjencia ruse lajmeve Tass specifikon më tej: atak në zemër, ndërsa kurohej edhe me anti-depresivë.

Me pak fjalë, ekzistojnë dy hipoteza. E para, u rrezua nga agjentët e shërbimit sekret pasi bordi i Lukoil kritikoi hapur në mars operacionin ushtarak në Ukrainë, duke bërë thirrje për "përfundim të shpejtë të konfliktit të armatosur", dhe shprehur "afërsi të sinqertë me të gjitha viktimat". Së dyti, i dëshpëruar nga të qenit numri 2 i gjigantit të dytë rus të naftës, Maganov u ndje keq ndërsa po qëndronte në dritare dhe u rrezua poshtë.

I pari në listën me 12 viktima vdiq më 29 janar, ende pa nisur lufta.



Bëhet fjalë për Leonid Shulman, 60 vjeç, kreu i shërbimit të transportit të "Gazprom Invest". Thuhet se ai u gjet i vdekur në banjën e vilës së tij, në periferi të Moskës. Pranë iu gjet një shënim, në të cilin ai ankohej për dhimbje nga një këmbë e thyer.

Por sipas shërbimit sekret ukrainas, ai kishte prerje të thella në trupin e tij të gjakosur. Nga ana tjetër, sipas revistës "Fortune", Shulman ishte në telashe për shkak të një hetim përmashtim. Më 25 shkurt, ditën e parë të luftës, ndodhi vdekja e dyta. Ajo e Aleksandër Tjuliako, 61 vjeç, zëvendësrejtore i Bankës Gazprom.

Ai u gjet i varur në garazhin e vilës së tij. Edhe ai pati një shënim pranë, përmbajtja e të cilit ende nuk dihet. Shërbimi i sigurisë i Gazprom i përzuri që të gjithë nga vendi i krimit; madje edhe policinë. Më 28 shkurt, i treti në listë ishte Majkëll Uorford, 66 vjeç. Emri i vërtetë Mikail Tolstosheja, me origjinë ukrainase.

Pasi u bë i pasur nga nafta dhe gazi, ai emigroi në vitin 2000 në Britaninë e Madhe, ku ndryshoi shtetësinë, emrin dhe veprimtarinë profesionale, duke u marrë me pasuritë e paluajtshme. Trupi i tij u gjet gjithashtu në një garazh në shtëpinë e tij në Sarrej. Policia britanike përjashton pistën e vrasjes, por e quan vdekjen si "të pashpjegueshme".

Më 23 mars, ishte radha e Vasili Melnikov, 43 vjeç, pronar i kompanisë Medstom që importon pajisje mjekësore. Në apartamentin e tij luksoz në Nizhni

Novgorod nuk u gjet vetëm trupi i tij, por edhe i gruas dhe i 2 fëmijëve. Shkaku i vdekjes: plagë me thikë të shkaktuara nga disa thika të gjetura në vendin e krimit.

Për shkak të sanksioneve, Medstom ishte në prag të falimentimit. Më 18 prill, i pesti në listë ishte Vladislav Avaev, 51 vjeç, nëndrejtor i Gazprombank dhe ish-zyrtar i Kremlinit. Sërish pranë trupit të tij në shtëpinë e tij në Moskë u gjetën ato të gruas së tij dhe një vajze 13-vjeçare.

Po ashtu edhe një armë, me të cilën ai do t'i vriste fillimisht 2 gratë, dhe më pas do të kryente vetëvrasje. "E vrau Putin" – ishte akuza e forte e Igor Volobuev, ish-zëvendësrejtore i Gazprom, që u arratis dhe shkoi në vendlindjen e tij në Ukrainë, për të luftuar kundër pushtuesve.

Më 21 prill, është radha e Sergej Protosenja, 55 vjeç, menaxheri kryesor i Novatek, gjiganti i dytë në madh energjetik në Rusi pas Gazprom, me një pasuri personale prej 400 milionë eurosh. Kufoma e tij u gjet së bashku me atë të gruas dhe vajzës 18-vjeçare në Lloret de Mar, 70 km larg Barcelonës, në një vilë të marrë qira për festën e Pashkëve.

Ai ishte mbytur, ndërsa 2 femrat ishin të goditura me thikë. Djali i familjes që në atë moment ndodhej në Francë, e përjashton absolutisht skenarin vrasje-vetëvrasje. 1 maji regjistroi vdekjen e shtatë misteroze. Andrei Krukovski, 37 vjeç, drejtor i resortit të skive Gazprom në Krasnaja Poljana, vdes në Kaukaz.

Sipas agjencisë së lajmeve Tass, "ai u

rrezua nga një shkëmb" në Soçi. "Ai i donte malet dhe aty e gjeti paqen. Tragjedia ndodhi në rrugën për në fortesën Akzepsinskaja"- vijoi raportimi. Më 7 maj, i teti në listë ishte Aleksandër Subotin: 43 vjeç, ish-drejtes i Lukoil, por anëtar i Bordit të Drejtorëve, si dhe vëllai i tij Valeri Subotin, ish-zëvendës president i seksionit tëblerjes dhe shitjes së naftës në Lukoil.

Ai vdiq nga një sulm në zemrës, pasi iu nënshtrua një kure popullore në Mitisci, 19 km larg Moskës. Ishte një tepari, së cilës ai i nënshtrohej shpesh për t'u shëruar nga varësia nga alkooli. Kura bazohej tek helmi i bretkosave, që shmang të vjellat dhe në të njëjtën kohë e forcon sistemin imunitar.

Në të njëjtën kohë, mjekët popullore thërrasin shpirtat, duke sakrifikuar disa gjela dhe duke u larë me gjakun e tyre. Por këtë herë ai u ndje kaq dhe shamani Magua, me gruan e tij, në vend se t'i telefononin menjëherë urgjencës, preferoi të provonte ilaçin Korvalol, një qetësues i bazuar në barishte natyrale.

Më 27 qershor, i nënti ishte Jevgeni Palant, 47 vjeç, me origjinë ukrainase, pronar i kompanisë celulare, A-Mobile, aktive në Abkhazi, dhe gjithashtu financier i një Teatri Dramatik Rus në të njëjtën republikë të shkëputur nga Gjeorgjia.

Trupi i tij i zhveshur u gjend në rrethinat e Moskës, pranë gruas së tij Olga, 50 vjeçe, nga vajza 20-vjeçare Polina. Pasi zbuloi se donte ta linte, gruaja e goditi 14 herë me thikë. Më pasvizatoi në mur dy zemra me gjakun e saj, dhe në fund

u vetëvra. Kështu pretendojnë mediat pro-qeveritare.

Më 5 korrik, i dhjeti ishte Juri Voronov, 61 vjeç, pronar i Astra-Shipping, një kompani logjistike që kishte nënshkruar disa kontrata me Gazprom për shpimet në Arktik. Trupi i tij u gjet në mesin e pishinës në banesën e tij luksoze, me një plumb në kokë dhe një armë aty pranë.

Hetuesit thanë se vdekja u shkaktua nga një "mosmarrëveshjeje me partnerët e biznesit", pasi sipas të vesë, bashkëshorti ankohej se njerëzit po e tradhtonin. Por kamerat e sigurisë nuk tregojnë asnjë vizita apo hyrjen e ndonjë të panjohurit në orët para ngjarjes.

Më 14 gusht, i njëmbëdhjeti në listë është Den Rapoport, 52 vjeç, financier dhe ndërmjetës me origjinë letoneze. Pasi u bë i pasur në Rusi, ai u largua jashtë vendit duke u bërë një kritik i fortë i qeverisë së Putinit. Rrëzohet orët e vona të natës nga një godinë në Uashington.

Në momentin e vdekjes së tij, në kokë mbante një kapele portokalli, ndërsa në dorë kishte 2620 dollarë, por as portofol dhe as kartë krediti. Rrethanat e vdekjes së tij përshkruhen si "tejet të dyshimta" nga Bill Brouder, një ish-financier amerikan që dikur ka punuar në Moskë, djali i një lideri të famshëm të Partisë Komuniste të SHBA-së, që u bë më vonë një nga mbështetësit kryesorë të sanksioneve kundër Rusisë së Putinit pas vrasjes të avokatit të tij rus Sergei Manjicki në vitin 2009. /

"Linkiesta" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Giresse fton tre lojtarë nga Superliga, rikthen Paqaradën

Lumbardh Dellova, Lindon Emerllahu dhe Ilir Krasniqi janë tre futbollistët e ftuar nga përzgjedhësi Giresse për ndeshjet e shtatorit, kurse në përfaqësuese është rikthyer edhe mbrojtësi Leart Paqarada

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Alain Giresse, të premten e ka publikuar listën e futbollistëve për dy ndeshjet e muajit shtator që "Dardanët" i zhvillojnë kundër Irlandës së Veriut më 24 shtator në Belfast dhe me Qipron më 27 shtator në Prishtinë. Për këto dy ndeshje që janë të fundit në Ligën e Kombeve, përzgjedhësi ka ftuar 26 futbollistë, kurse risi është

ftesa për tre lojtarë nga Superliga e Kosovës, dy nga Ballkani, Lumbardh Dellova dhe Lindon Emerllahu, dhe një nga skuadra e Llapit, Ilir Krasniqi. Në përfaqësuese, pas një kohe të gjatë, rikthehet edhe Leart Paqarada, por jo edhe Bernard Berisha. Përzgjedhësi Giresse nuk e ka ftuar as kapitenin e Ballkanit, Armend Thaqi, i cili është duke shkëlqyer edhe në këtë edicion. Ai ka qenë ndër më të mirët për skuadrën kampione në Ligën e Konferencës. Gazeta e ka kontaktuar ditë më

parë Thaqin lidhur me atë se a pret një ftesë nga Përfaqësuesja derisa ai është përgjigjur: "Jam gjithmonë i gatshëm të paraqitem për vendin tim dhe ta jap maksimumimin, por për ftesë vendos trajneri". Në njoftimin e Federatës së Futbollit është bërë me dije se stërvitjen e parë "Dardanët" e zhvillojnë të hënën me fillim nga ora 19:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". Ndërkaq përzgjedhësi Alain Giresse do të paraqitet në konferencë për medie të martën në orën 13:00 në "Hotel Emerald".



Lista e futbollistëve

Arjanet Muriq, Visar Bekaj, Samir Ujkani, Florent Hadergjona, Mërgim Vojvoda, Donat Rrudhani, Amir Rrahmani, Mirlind Kryeziu, Leart Paqarada, Betim Fazliji, Lumbardh Dellova, Fidan Aliti, Ibrahim Dresheviq, Ilir Krasniqi, Lindon Emerllahu, Hekuran Kryeziu, Bersant Celina, Florent Muslija, Florian Loshaj, Toni Domgjoni, Vedat Muriq, Elbasan Rashani, Milot Rashica, Zymer Bytyqi, Shkëlqim Vladi, Arber Zeneli.

Hendbolli fillon me ndeshje interesante



PRISHTINË, 16 SHTATOR - Ndeshje interesante dhe me rivalitet pritet të zhvillohen në javën e parë të edicionit 2022/2023 të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencën e meshkujve. Besa Fangas e nis mbrojtjen e titullit në Mitrovicë, ku takohet me Trepçën. Ndeshja luhet të shtunën nga ora 17:30. Skuadra pejana llogaritet favorite, por mitrovicasit janë të vendosur ta japin maksimumin për ta bërë ndeshjen të paqartë deri në fund. Të dyja skuadrat kanë bërë ndryshime gjatë verës dhe shpresojnë në fillim të mbarë. Xhiron e hap ndeshja Kastrioti - Vushtrria që, po ashtu, pritet të jetë me rivalitet. Edhe këto dy skuadra janë organizuar mirë dhe

kanë sjellë lojtarë të shumtë. Andaj me të drejtë pritet ndeshje cilësore. Ndeshja Kastrioti - Vushtrria luhet nga ora 17:00, të shtunën, në palestrën në Kaçanik. Të shtunën është edhe ndeshja Rahoveci - Llapi, që fillon në orën 19:00. Skuadra vendase llogaritet favorite. Xhiroja e parë mbyllet me ndeshjen Deçani - Vëllaznimi, që luhet të dielën nga ora 18:00. Skuadra deçanase dhe ajo gjakovare kërkojnë ta hapin kampionatin me fitore dhe pritet të ofrojnë një ndeshje të bukur. Para seniorëve, ndeshjet e zhvillojnë skuadrat e kadeteve. Me ndeshjen ndaj Samadrexhës, skuadra e Istogut e fillon mbrojtjen e titullit të kampionit të

Kosovës në hendboll në konkurrencën e femrave. Ndeshja Istogu - Samadrexha luhet të shtunën nga ora 18:00. Skuadra e Istogut është favorite, por samadrexhaset do ta japin më të mirën. Të shtunën luhen edhe dy ndeshje të tjera të xhiros së parë në Superligën e hendbollisteve. Nga ora 15:00 luhet derbi gjakovar në mes të Shqiponjës dhe Vëllaznimit, kurse prej orës 18:00 takohen Jusuf Gërvalla e Vushtrria. Dy ndeshje të tjera janë të dielën. Nga ora 16:00 është kryendeshja e xhiros në mes të Prishtinës dhe Ferizajt, derisa ndeshja Dukagjini - Kastrioti luhet nga ora 17:30. Para ndeshjeve të senioreve luhen ato të kadeteve.

Ballkani reagon pas incidentit ajror: Mund të përfundonte me fatalitet

SUHAREKË, 16 SHTATOR - Skuadra e Ballkanit ka pasur një mbrëmje plot ankth. Aeroplani me të cilin lojtarët po ktheheshin nga Çekia në Prishtinë, pas ndeshjes së zhvilluar ndaj Slavia Prahës në Ligën e Konferencës, pësoi dëmtime në xham. Pas kësaj ngjarjeje kryesia e Ballkanit ka

shkruar në "Facebook", e cila e ka cilësuar incidentin të frikshëm. "Pas një ndodhie mbrëmë kur u nisëm për Kosovë, ende pa e kaluar shtetin e Çekisë, dritarja e aeroplanit kishte filluar të plasaritej. Kjo ngjarje mund të përfundonte me fatalitet por, falë Zotit, sot mbërritëm shëndosh e

mirë në Prishtinë. Falënderojmë përzemërsisht mediet që informuan gjithçka dhe tifozët shqiptarë për përkrahjen dhe mesazhet e panumërta", thuhet në njoftimin e Ballkanit. Ekspedita e skuadrës së Ballkanit, pas fluturimit të dytë, ka mbërritur të premten në mëngjes në Prishtinë.



Shiu shtyn turneun e Beach Volley

Prishtinë, 16 shtator - Turneu MIX i Beach Volley, i planifikuar të nisë të premten, është shtyrë për shkak të kushteve jo të favorshme atmosferike. Lajmi është dhënë

nga Federata e Volejbollit e Kosovës në faqen e tyre në "Facebook". "Turneu i volejbollit në rërë, i organizuar nga Federata e Volejbollit e Kosovës (FVK) dhe

komuna e Prishtinës, i planifikuar të zhvillohet sot, është shtyrë për një datë tjetër për shkak të kushteve të vështira atmosferike të premten", ka njoftuar FVK-ja.

Të reshurat e shiut kanë pamundësuar zhvillimin e këtij turneu në datën e paraparë, ndërsa tash do të përcaktohet një datë e re.



Marko Simonovski, 'ylli i javës' në Superligë

GJILAN, 16 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Çmimi i më të mirit në javën e shtatë i ka takuar futbollistit të FC

Drita, Marko Simonovski. Ky i fundit shënoi tri gola në ndeshjen derbi ndaj Gjilanit (4-1). Pasi mori këtë çmim sulmuesi nga Maqedonia e Veriut u shpreh i lumtur që edhe në këtë edicion po gëzon

formë të mirë dhe po e jep kontributin e pritur për skuadrën. "Ky çmim për mua do të thotë shumë. Shpresoj që këtë edicion do të kthehem shumë herë për ta marr çmimin e më të mirit të javës. Mendoj se

Drita do të ketë një kampionat më të mirë sesa në edicionin e kaluar. Besoj se këtë herë do të dalim kampionë dhe për këtë po punojmë ndeshje pas ndeshje", ka thënë Simonovski për faqen zyrtare të FFK-së.



Reja publikon listën, katër mungesa për ndeshjet ndaj Izraelit dhe Islandës



TIRANË, 16 SHTATOR - Kombëtarja shqiptare do t'i luajë sfidat e fundit në grupet e Ligës së Kombeve kundër Izraelit në transfertë dhe Islandës. Trajneri i kombëtares, Edoardo Reja, ka shpallur edhe listën me emrat e 24 lojtarëve që do të grumbullohen për këto dy sfida vendimtare për renditjen e Shqipërisë. Berat Gjimeshi, Marash Kumbulla, Rey Manaj dhe Odise Roshi do të mungojnë për shkaqe dëmtimesh, ndërkohë që janë rikthyer Arlind Ajeti, Albi Doka dhe është konfirmuar Adrian Bajrami. Përfaqësuesja kuqezi do të grumbullohet këtë fundjavë në

kompleksin Tropikal në Durrës dhe pas pesë ditësh përgatitje do të nisët për në Izrael, ku të shtunën, datë 24 shtator, në mbrëmje do të përballet me vendasit në një nga ndeshjet më të rëndësishme të grupit në ndeshjen që luhet në stadiumin "Bloomfield" të Tel Avivit. Më datë 27 shtator Shqipëria do ta presë Islandën në stadiumin "Air Albania" për duelin e fundit të grupit, që nis në orën 20:45. Të shtunën në mesditë trajneri Reja do të jetë në një konferencë për shtyp para gazetarëve për të folur në lidhje me listën e lojtarëve dhe objektivat në këto dy ndeshje.

Lista e futbollistëve

Etrit Berisha, Thomas Stakosha, Elhan Kastrati, Elsie Hysaj, Arlind Ajeti, Ardian Bajrami, Ardiyan Ismajli, Albi Doka, Ermir Lenjani, Enea Mihaj, Frederik Veseli, Ivan Balliu, Keidi Bare, Kristijan Asllani, Klaus Gjasula, Amir Abrashi, Ylber Ramadani, Nedim Bajrami, Qazim Laçi, Endri Çekiçi, Myrto Uzuni, Taulant Seferi, Armando Broja, Sokol Cikalleshi.

LeBron synon ta thyejë rekordin më të rëndësishëm në NBA

LOS ANXHELOS, 16 SHTATOR - Sezonin e ri 2022-2023, basketbollisti LeBron James mund ta thyejë rekordin më të rëndësishëm në NBA: të bëhet lojtari që ka realizuar më shumë pikë në histori. Për momentin, ylli i Lakersit ndodhet i dyti në këtë renditje me 37 062 pikë. Ai ka 1 325 pikë më pak se legjenda Kareem Abdul-Jabbar, që kryeson renditjen me 38 387 pikë. Një rekord që mund të realizohet pa shumë mund nga "king James", që i mjafton të realizojë mesatarisht 16 pikë për ndeshje që ta thyejë atë. Mesatarja e pikëve të LeBron Jamesit me fanellën e lakersave është 27 pikë për ndeshje. Pra, në mesin e këtij sezoni ai mund ta vendosë rekordin



e madh. Vitin e fundit ai luajti 56 ndeshje në kampionat dhe realizoi 1 625 pikë. Nëse do të jetë në formë dhe pa dëmtime, ai mund ta realizojë objektivin e tij shumë më

herët, duke u bërë shënuesi më i mirë në historinë e NBA-s. Natyrisht që objektivi tjetër është edhe ai i fitimit të titullit kampion me lakersat.

SHKURT

Vdes gjyqtari i boksit, Aliriza Rexhepi

Federata e Boksit e Kosovës ka njoftuar se gjyqtari i boksit, Aliriza Rexhepi, ka vdekur. Vdekja e tij ka tronditur botën e boksit të Kosovës dhe po vlerësohet ndër humbjet më të mëdha. "Ne si federatë dhe komunitet i boksit jemi të tronditur me lajmin e trishtë, ikjen në amshim të gjyqtarit të boksit Aliriza Rexhepi. Kemi humbur një figurë të veçantë sportive, një gjyqtar të mrekullueshëm dhe që ishte shembull i referimit. Boksi është shumë më i varfër pa një gjyqtar siç ishte Aliriza Rexhepi. Përkushtimi në punë dhe idetë e tij ishin mahnitëse, kurse modestia që e karakterizonte e bënte atë të veçantë", thuhet në njoftimin e federatës.

Barcelona emëron drejtor Jordi Cruyffin

Skuadra e Barcelonës e ka zgjedhur drejtorin e ri sportiv të klubit dhe këtë detyrë drejtuesit ia kanë besuar Jordi Cruyffit. Djali i legjendës holandeze të futbollit prej kohësh kishte një rol në klubin katalanas dhe duket se tashmë ai është ngritur në detyrë. Jordi Cruyff do të nisë menjëherë punën për merkaton e janarit, në të cilën Barcelona do të kërkojë që të ofrojë sërish lojtarë.

Bagnaia: I kam kërkuar Rossit të jetë trajneri im

"I kam kërkuar Valentino Rossit të jetë trajneri im, por ai nuk është përgjigjur ende". Ka qenë kjo deklarata e bërë nga pista e Aragonit e pilotit italian Francesco Bagnaia, që synon ta fitojë titullin e parë kampion bote në MotoGP. "Të shohim nëse me kalimin e kohës do të më ndihmojë sërish. I kam kërkuar që të vijë të më shohë në ndonjë garë. Të më shohë nga jashtë dhe të bëjë tifo si trajneri im. Më ka premtuar se kur do të vijë do të më ndihmojë", ka shtuar Bagnaia. "Shpresoj që vitin tjetër të vijë më shpesh. Është i jashtëzakonshëm si trajner dhe falë tij jam sot në MotoGP, pasi më ka përkrahur e mësuar shumë në kategoritë e vogla para se të vija këtu", u shpreh piloti i Ducatit.

Juventus vendos ta largojë Cuadradon

Juan Cuadrado këtë sezon ka qenë një ndër më të dobët të skuadra e Juventusit. Mbrojtësi kolumbian jo vetëm që nuk ka bërë mirë në fazën e sulmit, por dhe në mbrojtje ka bërë shumë gabime. "Bardhezinjtë" tashmë duket se nuk kanë plan për të rinovuar me të. 34-vjeçar i bashkuar në 2017-n me italianët, megjithatë tashmë duket se te Juventusit nuk ka më vend për të. Mediet italiane raportohet se Juventusit do të shpëtojë sa më shpejt nga kolumbiani dhe do ta merrte në konsideratë çdo ofertë për të.

Alves: Pele dhe Messi janë në një kategori

Futbollisti i njohur brazilian Dani Alves e krahasoi bashkëkombasin e tij Pele me argjentinianin Lionel Messi. "Messi

ndryshoi një brez të tërë futbollit, por për mua Pele nuk duhet të jetë në asnjë mosmarrëveshje për titullin e më të mirëve me askënd.

Futbollisti më i mirë në histori? Messi. Pele është në kategorinë e tij", ka thënë mbrojtësi 39-vjeçar, i cili tani luan në Meksikë për

Pumas. Dani Alves e njeh Lionel Messin pasi kanë luajtur bashkë te Barcelona. Braziliiani është rekordmeni aktual në mesin e të gjithë

lojtarëve në botë për sa iu përket trofeve të fituara dhe është sulmuesi 35-vjeçar i PSG-së ai që është ndjekësi i tij më i afërt.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "PEPA S LUM" - Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811383364 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "PEPA S LUM" - d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811383364 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "PEPA S LUM" - L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811383364, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dreni Krusha shpall të pavlefshme 1 dëftesë të lëshuar nga SHMLT "11 Marsi" Prizren.

- Dibran Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

- Bledi Kurtaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

- Festim Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX SHFMU "Brigada 125" Medvec.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

